



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR	
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Niveli Org Org.Jedësica Org.Unit	SR 02
Nr i Prot Broj Prot Prot No.	7147-2/18
Nr i Fajve Broj Fajve No pages	03
Datim Datum Date	04, 10, 19
Prishtinë / a	

<b>DATË/A:</b>	03.10.2019
<b>REFERENC-Ë:</b>	18/7147/857/DMMU
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec Qendër grumbulluese të mbeturinave metalike dhe komponentëve të tyre në Krushë të Vogël Rahovec
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për Leje Mjedisore

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec, me nr. prot. 18/7147/857/DMMU, të datës 03.12.2018.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartcekur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

1. Vendimi për refuzim të kërkesës për Leje Mjedisore për "LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec, për qendrën grumbulluese të mbeturinave metalike dhe komponentëve të tyre në Krushë të Vogël Rahovec.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

**V E N D I M**

**Refuzim i kërkesës për Leje Mjedisore**

Kompanisë "LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec, për qendrën grumbulluese të mbeturinave metalike dhe komponentëve të tyre në Krushë të Vogël Rahovec.

**A r s y e t i m**

Pas shqyrtimit të kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec, për qendrën grumbulluese të mbeturinave metalike dhe komponentëve të tyre në ngastrën kadastrale nr. P- 71813053, me sipërfaqe 1118 m<sup>2</sup>, bazuar në përshkrimin në aplikacion, si dhe bazuar në një të pëlqim komunal i bashkangjitur lëndës, parcela nr. 2137-2, me sipërfaqe 1118 m<sup>2</sup>, zona kadastrale Krush e Vogël- Rahovec, komisioni për Leje Mjedisore pas realizimit të vizitës në teren ka kërkuar nga kompania që të plotësoj informata shtesë.

Mungojnë:

- Pëlqimi Mjedisor nga MMPH;
- Certifikatë e përdorimit (të objektit) nga Komuna;

Faqe 2 nga 3



- Pikat: 2.1.1, 2.1.2, 4.1, 5.1.5, kapitulli 6. dhe 7, si dhe pika 8.1.2, në aplikacion nuk janë plotësua në përputhje me pyetjet në aplikacion dhe gjendjen në terën;
- Sqarim lidhur me nxjerrjen e acidit sulfurik nga bateritë, nuk është bërë në përputhje me gjendjen në terën;
- Pjesët që kanë përmbajtje të vajrave nuk janë vendosur në hapësirë të betonuar (izoluar) dhe mbuluar;
- Mbeturinat nuk janë të klasifikuara sipas llojit të mbeturinave, mungojnë tabelat me mbishkrim të llojit mbeturin të vendosura të çdo lloj grupi i mbeturinave.

Pasi që kompania në fjalë nuk i ka sjell informatat shtesë të cekura me lartë, nuk janë përmbush kushtet teknike dhe mjedisore, dhe ka mungesë të dokumentacionit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, merr vendim për **Refuzimin e kërkesës për Leje Mjedisore** të kompanisë "LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec, për qendrën grumbulluese të mbeturinave metalike dhe komponentëve të tyre në Krushë të Vogël Rahovec.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 18/7147/ZSP/471/19 datë: 03.10.2019.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPH-së



Arben ÇITAKU  
Sekretar i Përgjithshëm

Faqe 3 nga 3